



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

PRISHTINË, 14 DHJETOR 2010
NR. REF.: RK 71/10

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 49/09

**Parashtruesi
Veli Sermaxhaj**

VLERËSIMI I KUSHTETUTSHMËRISË

të

**Vendimit të Gjykatës Komunale në Gjilan, E. nr. 299/05,
të datës 26 maj 2009**

dhe

**Vendimit të Gjykatës Komunale në Gjilan, P. nr. 772/05,
të datës 26 mars 2009**

dhe

**Vendimit të Gjykatës Komunale në Gjilan, Ed. nr. 44/09,
të datës 25 nëntor 2009**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Veli Sermaxhaj me banim në Gjilan.

Vendimet e sfiduara

2. Vendimet e sfiduara janë:
 - a. Vendimi i procedurës civile i Gjykatës Komunale në Gjilan, E. nr. 299/05, i datës 26 maj 2009, që iu dërgua parashtruesit më 4 korrik 2005;
 - b. Vendimi i procedurës penale i Gjykatës Komunale në Gjilan, P. nr. 772/05, i datës 26 mars 2009, që iu dërgua parashtruesit më 7 prill 2009; dhe
 - c. Vendimi për ekzekutim i Gjykatës Komunale në Gjilan, Ed. nr. 44/09, i datës 25 nëntor 2009, që iu dërgua parashtruesit më 26 nëntor 2009.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon që eksperti i caktuar nga Gjykata Komunale në Gjilan për vlerësimin e pronës e ka shkelur detyrën zyrtare dhe që ai ka kërkuar nga Gjykata Komunale që të aplikojë nenet 30 (Aplikimi i Dispozitave të përgjithshme për Përgjegjësinë penale), 39.3 [dënimi me gjobë], 43.2 [dënimi me kusht] të Kodit të Përkohshëm penal të Kosovës, Rregulloren 2003/25 (në tekstin e mëtutjeshëm - KPPK). Më tutje ai pohon që Prokurori, i cili është shok me palën e tretë, e ka kërcënuar atë me burgim dhe likuidim nëse parashtruesi nuk ia paguan borxhin palës së tretë.
4. Parashtruesi nuk është thirrur në asnjë nen të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm - Kushtetuta).

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, Neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i datës 16 dhjetor 2008 (në tekstin e mëtutjeshëm - Ligji) dhe Neni 54(b) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm - Rregullorja e Punës).

Procedurat para Gjykatës

6. Më 5 tetor 2009, parashtruesi parashtrojë kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm - Gjykata).
7. Më 22 Tetor 2009, Gjykata i ka dërguar letër parashtruesit ku e ka njoftuar që ai duhet ta plotësojë një aplikacion për të parashtruar kërkesën në Gjykatë.
8. Më 3 nëntor 2009, parashtruesi parashtrojë kërkesë në Gjykatë.
9. Më 15 nëntor 2009, parashtruesi dorëzojë një parashtrësë tjetër në Gjykatë me të cilën thoshte që eksperti i caktuar nga Gjykata Komunale në Gjilan për vlerësimin pronës e ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare.
10. Më 18 shkurt 2010, Sekretariati ia ka komunikuar kërkesën Gjykatës Komunale në Gjilan, e cila ka paraqitur përgjigjen e saj më 9 mars 2010, me ç'rast ia ka paraqitur Gjykatës terë historinë kronologjike të rasteve civile dhe penale. Gjykata komunale ka qartësuar që sipas mendimit të saj, nuk është shkelur asnjë e drejtë e parashtruesit dhe që ai kishte marrë pjesë në çdo seancë gjyqësore dhe e kishte të drejtën të ankohej kundër çdo aktgjykimi.

11. Më 13 dhjetor 2010, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtare raportuese, Snezhana Botusharova, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga Zëvendëskryetari Kadri Kryeziu (kryesues) dhe Kryetari Enver Hasani dhe gjyqtarja Iliriana Islami, ia rekomanduan atë Gjykatës së plotë.

Përmbledhje e fakteve

12. Në kërkesën tij, parashtruesi ankohet për vendimet e gjykatës që janë marrë në dy raste të ndryshme civile dhe një rast penal.

Sa i përket procedurave civile

13. Rasti i parë civil kishte të bënte me një borxh që kompania e parashtruesit ("NPT Vlora VS") ia kishte "Bankës Kreditore Sh.a." në Prishtinë (në tekstin e mëtutjeshëm - Kreditori).
14. Më 25 prill 2005, kreditori e ka dorëzuar pranë gjykatës komunale në Gjilan një kërkesë për ekzekutim me anë të sekuestrimit dhe konfiskimit të kolateralit dhe shitjes së pronës së patundshme, pasi që parashtruesi nuk e kishte përmbushur obligimin e tij që buronte nga marrëveshja e kredisë e lidhur më 9 mars 2004.
15. Më 26 maj 2005, Gjykata Komunale lejojë ekzekutimin e kërkesës së kreditorit (Vendimi E. nr. 299/05). Parashtruesi nuk parashtroi ankesë kundër këtij vendimi.
16. Më 6 shtator 2005, Gjykata Komunale në Gjilan kishte pezulluar procedurën e ekzekutimit, pasi që parashtruesi dhe kreditori kishin arritur marrëveshje gjyqësore.
17. Më 9 maj 2006, kreditori parashtrojë kërkesë për ekzekutim pranë gjykatës, duke pohuar që parashtruesi nuk e ka përmbushur obligimin e tij në bazë të marrëveshjes gjyqësore.
18. Më 12 dhjetor 2006, Gjykata Komunale në Gjilan kishte vlerësuar çmimin e tregut të pronës së parashtruesit në bazë të vlerësimit të bërë nga eksperti financiar i caktuar nga gjykata.
19. Parashtruesi u ankua kundër këtij aktgjykimi pranë Gjykatës së Qarkut në Gjilan, e cila më 14 shkurt 2007, refuzoi ankesën si të pabazuar dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale.
20. Më 21 qershor 2007, Gjykata Komunale në Gjilan tërhoqi vendimin e saj të datës 28 maj 2007, me të cilin kishte shtyrë shitjen e pronës për gjashtë muaj, me kërkesë të kreditorit për kthim në gjendjen e mëparshme. Asnjëra palë nuk u ankua kundër këtij aktgjykimi.
21. Më 10 gusht 2007, Gjykata Komunale vendosi për ofertën më të mirë të bërë për pronën. Parashtruesi u ankua kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, e cila më 2 tetor 2007, e shpalli ankesën si të pabazuar dhe aprovoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan.
22. Më pas, parashtruesi parashtrojë kërkesë për revizion kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut për Gjykatën Komunale në Gjilan, e cila më 14 nëntor 2007, e refuzoi kërkesën si të palejueshme. Parashtruesi nuk u ankua kundër këtij aktgjykimi.

23. Parashtruesi pastaj kontestoi vendimin për ekzekutim dhe vlerësim të pronës pranë Gjykatës Komunale, e cila më 17 dhjetor 2007, refuzoi edhe këtë kërkesë si të pabazuar.
24. Më 25 shkurt 2009, parashtruesi parashtroi kërkesë për rigjykim pranë Gjykatës Komunale në Gjilan, e cila e refuzoi atë. Parashtruesi nuk u ankuan kundër këtij vendimi.
25. Më 8 maj 2009, Gjykata Komunale në Gjilan mori vendim që shitja e pronës është e pavlefshme sepse blerësi nuk e kishte paguar shumën brenda afatit ligjor. Ky vendim nuk u kontestua.
26. Më 26 gusht 2009, Gjykata Komunale në Gjilan morri vendimin E.nr. 299/05, 651/06 dhe 920/2007 për të caktuar ekspertizën për vlerësimin e pronës së paluajtshme të hipotekuar, derisa sipas konkludimit të Gjykatës së datës 1 shkurt 2010, vlera e pronës së hipotekuar është përcaktuar përmes vendimit që është pranuar nga të gjitha palët në procedurë dhe tani është në pritje të shpalljes së ankandit për shitjen e pronës së hipotekuar me qëllim të plotësimit të kërkesës së kreditorit për pagesë të borxhit.
27. Në rastin e dytë civil lidhur me pagesën nga ana e parashtruesit të borxhit palës së tretë, Gjykata Komunale në Gjilan mori vendim më 5 tetor 2005, që parashtruesi duhet t'ia paguaj këtë borxh atij personi. Parashtruesi nuk u ankua kundër këtij vendimi.

Sa i përket procedurave penale

28. Më 12 qershor 2003, parashtruesi lidhi marrëveshje për kredi.
29. Më 3 shkurt 2009, parashtruesi u thirr nga gjykata për t'u paraqitur në seancë më 10 mars 2009, sepse ishte akuzuar për mashtrim, sipas Nenit 261 (1) të Kodit Penal të Kosovës.
30. Mirëpo, pa e informuar Gjykatën, parashtruesi nuk morri pjesë në seancë, e cila pastaj u shty deri më 26 mars 2009.
31. Gjatë seancës më 26 mars 2009, parashtruesi pranojë fajin e tij dhe si rrjedhojë u shpall fajtor për mashtrim dhe u dënua me tre muaj burgim, i cili nuk do të ekzekutohej nëse brenda një viti ai nuk kryen ndonjë vepër penale (vendimi P.nr. 772/05).
32. Pastaj, prokurori u ankua kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Gjilan, duke thënë që gjykata komunale është dashur që të shqiptojë dënim më të rëndë.
33. Më 16 qershor 2009, gjykata e Qarkut në Gjilan e dënoi parashtruesin me tre muaj burgim.

Sa i përket ekzekutimit të vendimit P. nr. 772/05

34. Më 27 korrik 2009, Gjykata Komunale në Gjilan e aprovoi kërkesën e parashtruesit për shtyrje të ekzekutimit të dënimit.
35. Më 23 tetor 2009, Gjykata Komunale në Gjilan refuzoi kërkesën e parashtruesit për shtyrje të mëtutjeshme të ekzekutimit të dënimit si të pabazuar. Parashtruesi u ankua kundër këtij vendimi pranë Gjykatës së Qarkut e cila refuzoi ankesën si të pabazuar.

36. Më 25 nëntor 2009, gjykata komunale refuzoi kërkesën e parashtruesit për zëvendësim të dënimit me gjobë si të pabazuar (vendimi Ed. nr. 44/09).
37. Parashtruesi u ankua kundër vendimit të Gjykatës Komunale në Gjilan në Gjykatën e Qarkut në Gjilan, e cila më 10 dhjetor 2009, e refuzoi ankesën si të pabazuar

Pretendimet e parashtruesit

38. Parashtruesi pohon që vendimet e gjykatave të rregullta nuk ishin konsistente dhe që eksperti i caktuar nga gjykata dhe prokurori ishte i njëanshëm. Për më tepër, gjykatat nuk ia kanë lejuar atij që ta paraqes rastin si duhet në seancat gojore, e as të përfaqësohet nga avokati.
39. Në fund, ai ankohet që të gjitha rastet pranë Gjykatës Komunale në Gjilan janë trajtuar nga i njëjti gjyqtar.

Vlerësim i pranueshmërisë së kërkesës

40. Për të qenë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykatës i nevojitet, së pari, të shohë nëse parashtruesi i plotëson kriteret e pranueshmërisë të parapara në Kushtetutë dhe të specifikuara në Ligj dhe Rregullore të Punës.
41. Neni 113.7 i Kushtetutës thotë:
“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
42. Gjkata dëshiron të theksojë që arsyeja për ekzistimin e rregullit të shterjes është që t’iu lejojë autoriteteve përkatëse, përfshirë këtu edhe gjykatat, mundësinë për ta parandaluar apo rregulluar shkeljen e supozuar të Kushtetutës, që paraqitet nga parashtruesi pranë këtyre autoriteteve. Ky rregull bazohet në supozimin që rendi juridik i Kosovës do të ofrojë mjete efektive juridike për shkeljet e të drejtave kushtetuese. (Shih, Mutatis mutandis, ECHR, *Selmouni v. France*, nr. 25803/94, vendimi i 28 korrikut 1999). Mirëpo, nuk është e nevojshme që të drejtat kushtetuese të thirren shprehimisht në procedurat në fjalë. Përderisa çështja është nënkuptuar apo shterja e mjeteve juridike është bërë në substance (shih, mutatis mutandis, ECHR, *Azinët kundër Qiprios*, Nr. 56679/00, vendimin e 28 prillit 2004).
43. Gjkata ka aplikuar të njëjtin arsyetim kur ka lëshuar vendimin për papranueshmëri në rastin Universiteti AAB-RIINVEST Sh.p.k - kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, rasti KI 41/09 i datës 27 janar 2010, dhe vendimin për papranueshmëri në rastin Mimoza Kusari-Lila - kundër Komisionit Qendror Zgjedhor, rasti nr. KI 73/09 i datës 23 mars 2010.
44. Është e qartë nga parashtruesit që ai asnjëherë nuk i ka ngritur apo kërkuar shkeljet e supozuara pranë gjykatave të instancave më të larta, përfshirë edhe Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës.
45. Rrjedhimisht, parashtruesi në procedurat civile, penale dhe të ekzekutimit, nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion për të në bazë të Ligjit të aplikueshëm siç kërkohet nga Neni 113.7 i Kushtetutës dhe kërkesa e tij duhet të refuzohet si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të Nenit 113.7 të Kushtetutës, 47 të Ligjit, si dhe Nenit 54 (b) të Rregullores së Punës, në seancën e datës 14 dhjetor 2010, njëzëri:

VENDOS

- I. TË REFUZOJË Kërkesën si të papranueshme.
- II. Ky vendim do t'i komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me Nenin 20 (4) të Ligjit.
- III. Ky vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja Raportuese

Snezhana Botusharova, d.v.



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani, d.v.